

VENDIM
Nr. 133, datë 22.2.2017

PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK DHE PAKËSIMIN NË VOLUM TË SIPËRFAQES PREJ 14.4 HA NË OBJEKTIN “LAJTHIZË”, TË QARKUT TË LEZHËS, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA “BLEDI”, SH.P.K. PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT TË KROMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17, të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullosor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore dhe kullosore publike prej 14.4 ha, pjesë e ngastrave nr.38a, 41a dhe 41b në objektin “Lajthizë”, të ekonomisë pyjore “Lajthizë”, në qarkun e Lezhës, që do të përdoret nga shoqëria “Bledi”, sh.p.k. për shfrytëzimin e mineralit të kromit, të hiqet nga fondi pyjor e kullosor publik, të pakësohet në volum dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja 1, me të dhënat për sipërfaqen pyjore e kullosore, dhe harta topografike, me koordinatat e sipërfaqes objekt minerar, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të volumit të materialit drusor dhe të produkteve të tjera pyjore e kullosore, në sipërfaqen objekt minerar, paguhen nga shoqëria “Bledi”, sh.p.k. në bazë të vendimit nr.391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Bledi”, sh.p.k. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqet në përdorim sipas kushteve të lejeve mjedisore dhe, brenda vitit të parë, të pyllëzojë me fondet e veta një sipërfaqe pyjore prej 15 ha në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit.

4. Sipërfaqja pyjore dhe kullosore, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, mbetet pronë publike e shtetit dhe regjistrohet në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

5. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bën çregjistrimin e sipërfaqes pyjore, të identifikuar sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë e zënë pyjore” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për aktivitet minerar”.

6. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit sipas lejes mjedisore, nga shoqëria “Bledi”, sh.p.k., sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor dhe kullosor publik.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe shoqëria “Bledi”, sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË DO TË HIQEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT MINERAR NGA SHOQËRIA “BLEDI” sh.p.k. në qarkun e LEZHËS

QARKU Lezhe

Lidhja 1

<i>ID Prones</i>	<i>Ekon.Pyjore/Kullosore</i>	<i>Ngastra</i>	<i>Përdorimi territorit</i>	<i>Administrimi</i>	<i>Sip. qe hiqen nga fondi pyjor (ha)</i>
LE 21 00 038	Lajthize	38 a	trungishte	njqv	5
LE 21 00 041	Lajthize	41 a	bimesi pyjore	njqv	6.4
LE 21 00 041	Lajthize	41 b	inproduktive	ministra mjedisit	3
GJITHSEJ					14.40

HARTA TOPOGRAFIKE ME PARCELAT E PYJORES
LEJA MINERARE E SHFRYTEZIMIT Nr. 1515, OBJEKTI: "LAJTHIZE", OROSH, MIRDITE
SHKALLA 1:10 000



